
**SHENJAT DHE
SHKAQET E
PËRFUNDIMIT
TË MIRË**

HALID IBN ABDURRAHMAN



Shenjat e përfundimit të mirë dhe të keq

HALID BIN ABDURRAHMAN

**SHENJAT DHE SHKAQET
E PËRFUNDIMIT TË MIRË
DHE
PËRFUNDIMIT TË KEQ**

TIRANË 2011



*Falenderimet i takojnë vetëm Allahut. Zotit të botrave,
paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi profetin tonë
Muhamedin (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!).
shokët e tij dhe të gjithë ata që e pasojnë deri Ditën e
Gjyqimit.*

E në vijim...

Përfundimi i mirë.

Përfundim i mirë është, kur njeriu para vdekjes së tij i lë ato punë që e zemërojnë Allahun, pendohet për mëkatet e tij, bën punë që e kënaqin Allahun, dhe gjen vdekja në këtë gjëndje. Thotë Enes ibn Malik se ka thënë i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!): **“Kur Allahu ia don të mirën robit të Tij, e përdor Atë”** *Thanë si e përdor atë?! Tha: “I mundëson atij që të bëjë një punë të mira para vdekjes”*

(Transmeton Ahmedi dhe Tirmidhiu e vërtetoi Hakimi në “El-Mustedrak)

Përfundimi i mirë ka disa shenja, disa prej tyre i sheh ai që po vdes dhe disa të tjera u shfaqen njerëzve të tjerë. Shenjat që i sheh ai që po vdes janë përgëzimet se Allahu është i kënaqur me të dhe se Allahu me mirësinë dhe bujarinë e Tij do ta nderojë atë, sikurse thotë Allahu: **“E, s’ka dyshim se ata që thanë: “Allahu është Zoti ynë” dhe ishin të pa luhatshëm, atyre u vijnë ëngjujt në prag të**

vdekjes dhe u thonë: mos u frikësoni, mos u pikëlloni, keni myzhde xhenetin që u premtohet” (*Fusilet; 30*) ky përgëzim mund t’u vijë besimtarëve në prag të vdekjes, në varret e tyre apo ditën kur dotë ringjallen nga varret e tyre.

Një argument tjetër për këtë është hadithi të cilin e ka transmetuar Buhariu dhe Muslimi nga nëna e besimtarëve Aishja se i Dërguari i Allahut (*paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!*): **“Kush e don takimin me Allahun, Allahu e don takimin me të, kush e urren takimin me Allahun, Allahu e urren takimin e tij”**

Thotë Aishja a mos vallë kjo është për urrejtjen e vdekjes se çdo njëri prej nesh e urren vdekjen?! Tha i Dërguari i Allahut (*paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!*): **“Nuk është kështu, por kur besimtari përgëzohet me mëshirën e Allahut, kënaqësinë e Tij dhe me xhenetin e Tij, kështu ai dëshiron takimin me Allahun, ndërsa qafiri kur përgëzohet me dënimin e Allahut dhe zemërimin e Tij, ai e urren takimin me Allahun dhe Allahu e urren takimin e tij”**

Ka thënë Imam El-Kasim ibnu Selam: Nuk ka për qëllim hadithi urrejtjen e vdekjes dhe vështirësitë e saj, por qëllimi është për atë që i jep përparësi kësaj bote ndaj botës tjetër dhe është i kënaqur me këtë botë dhe urren kalimin tek Allahu dhe bota tjetër. Dhe gjithashtu thotë : Ajo që e bën të qartë këtë është se

Allahu ai tërhoqi vërejtjen një populli pasi ata u lidhën pas kësaj bote.

Thotë Allahu në Kur’an: **“Ata të cilët nuk shpresojnë takimin me ne dhe janë të kënaqur me jetën e dunjasë dhe kanë gjetur prehje në të dhe ndaj argumentave Tona janë indiferentë. Përfundimi i tyre është zjarri për shkak të asaj që punuan”** (*Junuz; 7*)



Thotë Hatabiu: *Që njeriu të dëshirojë takimin me Allahun, do të thotë që t'i japë përparësi ahiretit para dunjasë dhe gjithmonë të jetë i gatshëm për t'u larguar nga kjo botë.*

Ka thënë imam En-Neueuiu: Kuptimi i këtij hadithi është se dashuria apo urrejtja e takimit të Allahut është në prag të vdekjes në ato çaste që nuk pranohet pendimi dhe i shfaqet realiteti gjëndja dhe vendi i tij në ahiret.

Shenjat e përfundimit të mirë janë të shumta, dijetarët muslimanë duke u bazuar në tekste të ndryshme fetare, kanë konkluduar se prej këtyre shenjave janë:

1) Shqiptimi i shehadetit në prag të vdekjes dhe argument për këtë është hadithi të cilin e transmeton Hakimi dhe të tjerë se i Dërguari i Allahut (*paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!*) ka thënë: “Kush thotë fjalën e tij të fundit **“La ilahe illall-llah”** do të futet në xhenet”

2) Vdekja me djersë në ballë. Burejde ibnul Husejn transmeton se i Dërguari i Allahut (*paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!*) ka thënë: “Besimtari vdes me djersë në ballë” (ose “vdekja e besimtarit është me djersë në ballë”). (*Transmeton Ahmedi dhe Tirmidhiu*)

3) Vdekja natën ose ditën e xhuma transmetohet se i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) ka thënë : “Çdo musliman që vdes ditën e xhuma ose natën e xhuma Allahu do ta mbrojë nga sprova e varrit”

4) Të rënë të dëshmor në luftë për hir të Allahut ose atij që i vjen vdekja në luftë pa u vrarë.

5) Ai që vdes nga mortaja (*sëmundje ngjitëse*).

- 6) Ai që vdes nga sëmundje barku.
7) I mbyturi në ujë.

Argument për pesë pikat e fundit është hadithi të cilin e transmeton Muslimi në sahihun e tij që profeti (*paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!*) ka thënë: “**Kë konsideroni shehid?**” thanë - **O i dërguari i Allahut , ai që vritet në luftë është shehid. Tha pejgamberi** (*paqja dhe bekimi i Allahut*

qofshin mbi të!) : “**Atëherë dëshmorët e umetit tim qenkan pak**” *Atëherë kush janë o i dërguari i Allahut? -Tha:*

“Ai që vritet në luftë është shehid, kush vdes ngamortaja është shehid, kush vdes nga dhimbja e barkut është shehid dhe i mbyturi në ujë është shehid.”

8) Ai që e zënë rrënojat e shembjes. Argument për këtë është hadithi i Buhariut dhe i Muslimit se i dërguari i Allahut (*paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!*) ka thënë : “**Dëshmorët janë pesë ...dhe përmendi prej tyre atë që e mbytet nga shembja**”

9) Një shenjë tjetër, dhe kjo është vetëm për gratë, është vdekja gjatë shtatzanisë ose pas lindjes. Argument për këtë është hadithi i cili transmetohet nga imam Ahmed i me zinxhir transmetimi të vërtetë Ubade bin Samit (*r.a*) se i dërguari i Allahut (*paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!*) kur përmendi dëshmorët tha : “**Dhe ajo grua që vdes gjatë lindjes, do ta tërheqë fëmija e saj, përmes kërthizës së tij për në xhenet**”

10) Vdekja nga djegjet.

11) Ai që vdes nga sëmundja e **“Sul-lu”**, i dërguari i Allahut (*paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!*) ka njoftuar se ai është prej shëhidëve.

12) Disa shenja të tjera që i përmbledh hadithi të cilin e transmeton Ebu Daudi dhe Nesaiu dhe të tjerë

ku thotë i dërguari i Allahut (*paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!*): **“Kush vdes duke mbrojtur pasurinë e tij është shëhid, kush vdes duke mbrojtur familjen e tij është shëhid, kush vdes duke mbrojtur fenë e tij është shëhid dhe kush vdes duke mbrojtur gjakun e tij është shëhid.”**

13) Ai që vdes roje në rrugën e Allahut. Transmeton Muslimi se i dërguari i Allahut (*paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!*) ka thënë: **“Të qëndrosh roje në rrugën e Allahut një ditë e një natë është më mirë se sa të ajgërosh dhe të falesh një muaj, edhe nëse vdes do t’i vazhdojë puna që ka pas bërë po kështu edhe risku dhe sigurohet dhe do të (mbrohet) nga shejtani.”**

Ata që gëzohen më shumë nga ky hadith janë ata që merren me sigurinë e vendit, rojet e kufinjëve tokësor, detar dhe ajror, nëse shpresojnë tek shpërblimi i Allahut në punën e tyre.

14) Vdekja duke bërë një punë të mirë, thotë i dërguari i Allahut (*paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!*): **“Kush thotë: “La ilahe il-lall-llah për hir të Allahut dhe i përfundohet jeta me të, do të futet në xhenet. Kush agjëron një ditë për hir të Allahut dhe i mbyllet jeta me të, do të futet**



në xhenet dhe kush jep një sadaka (lëmoshë) për hir të Allahut dhe i mbyllet jeta me të, do të futet në xhenet”

(Transmeton Ahmedi dhe te tjerë)

Këto janë 20 shenja të përfundimit të mirë rreth të cilave ka folur dijetari i njohur Muhamed Nasrudin Albani në librin e tij *(Ahkamul-Xhenaiz/Rregullat e xhenazes)*

Dije vëlla i nderuar se shfaqja e ndonjërës prej këtyre shenjave nuk do të thotë me doemos se ai është prej banorëve të xhenetit, por kjo është një shenjë e mirë për të. Ashtu sikurse edhe mos shfaqja e ndonjërës prej këtyre shenjave nuk tregon se personi që po vdes është njeri i keq sepse e gjithë kjo është prej dijës së fshehtë që e di vetëm Allahu Lartëtësuar.

Shkaqet e përfundimit të mirë

1) Një nga shkaqet më të mëdha është devotshmëria dhe bindja ndaj Allahut. Çështja më parësore është plotësimi i teuhidit *(duke u larguar nga shirku i madh dhe i vogël)* dhe ruajtja nga haramet. Dhe pendimi sa më shpejt nëse njeriu ka rënë harame.

2) T'i kërkosh Allahut që ta marrë shpirtin me iman dhe devotshmëri.

3) Që të përpiqet njeriu që ta rregullojë veten e tij si brenda ashtu dhe jashtë dhe ta ketë si synim parësor se tradita e Allahut Lartësuar me atë që e kërkon të vërtetën është se ai i



Shtetjet e përfundimit të mirë dhe të keq

jep sukses atij, e forcon në të vërtetën dhe ia mbyll jetën po me të.



Së dyti: Përfundimi i keq

Përfundim i keq është : Që personin e gjen vdekja dhe ky i ka kthyer shpinën Zotit të tij, vazhdon të bëjë ato punë që e zemërojnë Allahun dhe lë detyrimet që ka ndaj Tij. S'ka dyshim se ky është një përfundim i keq për të cilin njerëzit e devotshëm e kanë frikë dhe i luten Allahut që t'i ruajë nga ky përfundim. Disa nga shenjat e përfundimit të keq i shfaqen atij personi që po vdes si p.sh:

Mos shqiptimi i shehadetit **“La ilahe il-lallah Muhamedun Resulull-llah”** ose refuzimi i tij.

Të flasë me fjalë të këqija dhe gjëra të ndaluara me të cilat ka qenë i lidhur me to në dynja ose diçka tjetër që na bën të ditur se ky person nuk ka qenë mirë me fenë e Allahut.

E pashë të arsyeshme për të sjellë disa shembuj të këtyre përsoneve.

1) Ibën Kajjim në librin e tij *“El Xheuabul-kafi”* thotë: Një personi që po vdiste i thanë thauj **“La ilahe il-lall-llah”** e ky tha çdo të më bejë dobi kjo fjalë kur unë nuk kam falur qoftë edhe një namaz, dhe vdiq pa e thënë.

2) Ibën Rexheb në librin e tij *“Xhamiul-Ulumul-Hikem”* tregon se një dijetar që quhej Abdulaziz ibën Ebi Reuad kishte prezantuar tek një person që po vdiste dhe njerëzit po i

kujtonin shehadetin dhe ky dijetari u tha atyre ai është mohues i asaj që ju po i thoni. Ai vdiq pa e thënë shehadetin.

Kur pyetën për këtë njeri morën vesh se ai vazhdimisht pinte alkol atëherë dijetari tha: Ruhuni prej mëkateve se ato e çuan atë njeri në atë gradë.

3) Ka thënë imam Dhehebiu se një person ulej me pirësit e alkolit dhe kur vdiq i thanë thuaj **“La ilahe il-lallah”** ai thoshte –**“Pi pak më jep edhe mua ...”** dhe vdiq.

4) Gjithashtu imam Dhehebiu në librin e tij *“El-Kebair”* një person që e luante shumë shahun gjatë momenteve të agonisë së vdekjes i përkujtonin shehadetin e ai përsëriste *“Shahu yt shahu yt...”* dhe vdiq. E kaloi jetën e tij me ato fjalë dhe me to e mbylli. Përmendi shahun në vend të shehadetit.

5) Ibën Kajim tregon se një person këndonte dhe i donte shumë këngët kur vdiq i thanë thuaj *“La ilahe il-lall-llah”* ai nuk e tha shehadetin por vazhdoi të këndonte deri sa vdiq.

6) Përsëri ibn Kajim tregon: Më ka njoftuar dikush për një tregtar i cili ishte në prag të vdekjes dhe njerëzit rreth tij i kujtonon shehadetin ndërsa ai thoshte: *Kjo copë është e lirë, kjo tjetra është kështu ..etj*, derisa vdiq dhe nuk e tha shehadetin.

Lusim Allahun që të na ruajë nga këto përfundime të këqija. Ibn Kajim duke shpjeguar këto ngjarje thotë : Sub’hanall-llah! Këto janë argumente për njerëzit por realiteti është më i madh

se kaq (*pasi shumë gjëra nuk shihen*). Nëse njeriu kur është në gjëndje të mirë fizike dhe psikike, mundet nga shejtani dhe e çon atë në gjynahe, ia largon zemrën nga përkujtimi i Allahut edhe gjymtyrët e tij nuk bëjnë punë të mira, vallë si do të jetë gjëndja e tij atë ditë kur do t'i humbë fuqitë dhe do të ketë

dhimbjet e vdekjes?!. Në këto çaste shejtani i mbledh të gjitha fuqitë e tij dhe angazhohet me gjithçka që posedon për ta

humbur këtë person nga rruga e drejtë. Shejtani i shfrytëzon këto mundësi pasi janë çastet e fundit të jetës së këtij personi dhe është në dobësinë e tij kulminante. Shejtani përforcohet ndërsa njeriu dobësohet në këto çaste e kush vallë do ta shpëtojë nga kjo? dhe në këtë vënd ***“Allahu forcon ata që besuan në fjalën e fortë (të mirë)***

në jetën e kësaj bote dhe në botën tjetër, ndërsa mizorët Allahu i bën të humbur. Allahu punon ç’farë dëshiron”
(*Suretu Ibrahim; 27*)

E si vallë mund të ketë sukses ai që zemra e tij është larg Allahut i ndjek epshet e tij dhe tejkalon kufinjt?. Larg do të jetë ai që është larg Allahut, i hutuar dhe ndjekës i epsheve të tij, rob i dëshirave të tij, gjuha e tij larg nga përmendaja e Allahut, gjymtyrët e tij nuk janë të bindura ndaj Allahut por janë të angazhuara me haramet. Ai person me këto cilësi është i pamundur që të ketë sukses në çastet e fundit të jetës.

Përfundimi i keq është në dy gradë, Allahu na ruajtë prej tyre. E para e cila është edhe më e madhja, kur një person dyshon ose mohon diçka në ogoninë e vdekjes, nëse vdes në këtë gjëndje kjo do të jetë një pengesë



ndërmjet tij dhe Allahut e kjo do të thotë që ai është në dënim të përhershëm dhe gjithmonë larg Allahut të Lartësuar.

Ndërsa grada e dytë e cila është më e vogël se e para, është kur i anon zemra tek gjërat e ndaluara të kësaj bote dhe kjo i mbetet në zemër deri sa vdes.

Ose personi vdes në atë punë që ka rënë më shumë në këtë botë. E nëse është prej atyre që merren me kamatë do ta mbyllë jetën me të dhe kështu kush kalon jetën me harame si droga, duhani, muzika, filmat dhe fotografitë e fëlliqura ose i bën padrejtësi njerëzve do t'i mbyllet jeta me këto vepra.



Shkaqet e përfundimit të keq

Përfundimi i keq ka disa shkaqe që duhet të ruhemi prej tyre. Prej tyre dhe më e madhja është:

1) Akidja (*besimi*) i prishur e kush ka besimin e prishur do të shfaqet kjo shenjë atë ditë kur robi ka nevojë për ndihmën e Allahut.

2) Të dhënit pas kësaj bote.

3) Të vazhduarit në mëkate dhe përshtatja me to, sepse nëse njeriu bën diçka shpesh e don atë dhe e lidh zemrën me të. Dhe do ta gjejë rezultatin atë ditë

kur do t'i vijë vdekja. Thotë Ibn Kethiri: “Me të vertetë mëkatet e tradhëtojnë njeriun në prag të vdekjes, dhe së bashku me dredhinë e shejtanit bashkohen tek ky njeri tradhëtia dhe dobësia e imanit dhe kështu bie në një përfundim të keq thotë Allahu:

“ Në të vërtetë, pasi e gjeta rrugën e drejtë, ai më largoi mua prej saj, e djalli është që e humb njeriun dhe e lë të vetmuar” (Furkan 29)

Përfundimi i keq Allahu na ruajt prej tij nuk bie në të ai person që i ka lidhjet e forta me Allahun si nga pamja e jashme ashtu dhe nga pamja e brendëshme. Si dhe ai që është i sigurtë në punë dhe fjalët e tij, kjo është diçka e pa dëgjuar, porse përfundim të keq kanë ata të cilët kanë dobësi në besim nga ana e brendëshme dhe kanë mangësi në punë anën e

jashtme dhe ata që janë guximtar në bërjen e krimeve dhe mëkateve të mëdha, ndoshta vazhdojnë në këtë gjëndje derisa tu vijë vdekja.”

Vëlla i nderuar !

Për këtë qëllim duhet që t’i kushtojmë rëndësi çastit të përfundimit të jetës dhe kjo realizohet duke iu larguar harameve dhe duke pasur zemrën gjithmonë të lidhura me Allahun kudo që të jemi, e nëse nuk veprojmë kështu atëherë do të jemi në hidhërim të përhershëm.

O Allah, bëji punët më të mira përfundimet e tyre, dhe jetën më të mirë përfundimin e saj dhe ditët më të mira ato ditë që do të takojmë ty. O Zot na mundëso që të bëjmë vepra të mira dhe na largo nga punët e këqija dhe së fundi dërgojmë paqë dhe mëshirë mbi profetin tonë Muhamedin (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!).



PASQYRA

Përfundimi i mirë.....	2
Shenjat e përfundimit të mirë	4
Shkaqet e përfundimit të mirë.....	7
Së dyti: Përfundimi i keq	9
Shkaqet e përfundimit të keq	14